

V E N D I M
Nr. 52, datë 23.1.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Moldavisë (më poshtë referuar si Palët):

Duke dëshiruar të lehtësojnë, në mënyrë të ndërsjellë, hyrjen, daljen dhe lëvizjen e shtetasve të tyre,
kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

1. Shtetasit e shtetit të secilës Palë, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, kanë të drejtë të hyjnë, dalin dhe të kalojnë transit nëpër territorin e shtetit të Palës tjetër pa viza.

2. Koha e qëndrimit pa viza e shtetasve të Palës tjetër në territorin e shtetit të Palës tjetër nuk duhet të jetë më tepër se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dita e hyrjes.

Neni 2

Shtetasit e vendit të Palës tjetër, të cilët janë anëtarë të përfaqësive diplomatike, misioneve konsullore ose organizatave ndërkombëtare, të akredituara në vendin e Palës tjetër, si edhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, kanë të drejtë të hyjnë në territorin e vendit të Palës tjetër pa viza.

Neni 3

Shtetasit e vendit të Palës tjetër, të cilët janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit duhet të hyjnë dhe të dalin nga territori i vendit të Palës tjetër nëpërmjet pikave kufitare të kontrollit, të hapura për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve.

Neni 4

1. Kjo Marrëveshje nuk i përjashton shtetasit e vendeve të të dy Palëve, të cilët janë mbajtës të

pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, nga detyrimi për të respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vendit të Palës tjetër.

2. Secila Palë ka të drejtë të refuzojë hyrjen, ose të shkurtojë kohën e qëndrimit të qytetarëve të vendit të Palës tjetër pa e motivuar vendimin e saj.

Neni 5

1. Secila Palë mundet, që për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik, ose shëndetit, të pezullojë të gjithë, ose pjesërisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Pala që vendos këto masa do të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë, pas marrjes së këtyre masave, nëpërmjet kanaleve diplomatike Palën tjetër, për vendosjen, si dhe për heqjen e tyre.

Neni 6

1. Palët do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike specimenet e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit.

2. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të këtyre pasaportave 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.

Neni 7

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit një Palë njofton Palën tjetër për përmbushjen e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar dhe do të qëndrojë në fuqi, deri kur njëra nga Palët të njoftojë me shkrim Palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike, për denoncimin e saj. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të përfundojë në ditën e 90-të (nëntëdhjetë) pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

Bërë në Porto/Portugali, më 6.12.2002 në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqipe, moldave dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë të barazvlefshme. Në rast kontradiktash, mbi interpretimin e këtyre dispozitave, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.